



REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
SENATI AKADEMIK

Nr. Prot.

Vlorë, më 13.06.2017

Vendim
Nr. 65, datë 13.06.2017

**PËR EMËRIMIN E DREJTUESVE TË
QENDRAVE KËRKIMORE-SHKENCORE TË FAKULTETEVE**

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 26, të pikës 2 të nenit 45 në Ligjin Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", Senati Akademik në mbledhjen e datës 13.06.2017

VENDOSI:

1. Dekanët të emërojnë drejtuesit e qendrave kërkimore-shkencore të fakulteteve, njësi të cilat nuk përmbushin standardet e njësisë bazë, për një periudhë njëvjeçare, në bazë të pikës 2 të nenit 45 të ligjit 80/2015.
2. Dekanët e fakulteteve të kryejnë këtë proces brenda datës **20.06.2017**, mbi bazën e vlerësimit të dosjeve dhe karrierave kërkimore, shkencore e botuese të personelit akademik të njësisë kryesore.
3. Zv/rektori për kërkimin shkencor, dekani i fakultetit dhe drejtuesi i emëruar i QKSH t'i propozojnë Rektorit kriteret për specialistët e QKSH-ve brenda datës **05 korrik 2017**.
4. Dekanatet e fakulteteve dhe përgjegjësit e emëruar të QKSH-ve të përgatisin: a) dokumentin e prioriteteve dhe fushave të studimit për QKSH, b) Rregulloren e funksionimit të QKSH, c) Planin e veprimtarisë shkencore, kërkimore e botuese të QKSH për vitin akademik 2017-2018.
5. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi dekanët e fakulteteve, dekanatet dhe Zv/rektori për kërkimin shkencor.
6. Vendimi regjistrohet dhe arkivohet.
7. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK
Prof. Dr. Roland ZISI

Ky dokument përpilohet në 3 (tri) kopje.



REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI “ISMAIL QEMALI” VLORE
SENATI AKADEMIK
